

URDHËR
Nr. 412, datë 24.9.2021

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 437, DATË 23.7.2020, “PËR
MIRATIMIN E PROCEDURËS SË KRYERJES SË TESTIMEVE MOLEKULARE
RT-PCR PËR SARS-COV-2 DHE NJOHJES SË LABORATORËVE JOPUBLIKË, PËR
KRYERJEN E TESTIMIT, PËR NEVOJA ADMINISTRATIVE”**

Në zbatim të nenit 100, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 10138, datë 11.5.2009, “Për shëndetin publik”, të ndryshuar; të nenit 5, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 3926, datë 22.9.2021, të Komitetit Teknik të Ekspertëve,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 437, datë 23.7.2021, “Për miratimin e procedurës së kryerjes së testimeve molekulare RT-PCR për Sars-Cov-2 dhe njohjes së laboratorëve jopublikë, për kryerjen e testimit, për nevoja administrative” bëhet një ndryshim, si më poshtë vijon:

1. Pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me këtë përmbajtje:

“Laboratorët e përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri, kryejnë edhe testimin e antigenit, sipas udhëzimeve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu